

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Suport, Licensa dhe mirëmbajtje për pajisjet hardware për 24 muaj”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

72610000-9 - Shërbimet e suportit kompjuterik

VLERA E FONDIT LIMIT:

17,865,000 (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 184,842 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e dy) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 07.11.2025 (1 EUR = 96.65 ALL).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt “Suport, Licensa dhe mirëmbajtje për pajisjet hardware për 24 muaj” ka për qëllim blerjen e suportit nga prodhuesi dhe mirëmbajtja e pajisjeve, infrastrukturës, sistemit backup dhe sigurisë së rrjetit të perimetrit të brendshëm dhe të jashtëm për të garantuar performancën dhe sigurinë në të gjithë segmentet LAN Access, Core dhe Egde/WAN.

Të gjitha këto licenca e platforma janë të ndërlidhura në një sistem të vetëm, ekzistues të disponuar nga AK.

Për këtë arsye, ndarja e kësaj procedure në Lote dhe rrjedhimisht mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, do të vështirësonte realizimin e kontratës, pasi operatorët ekonomikë të ndryshëm do të detyroheshin të punonin në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke ndikuar edhe në platformat përkatëse të secilit, duke sjellë bllokime të sistemeve qendrore të AK dhe vonesa të tyre.

Autoriteti Kontraktor është institucion i rëndësishëm në sistemin elektro-energjitik shqiptar dhe çdo vonesë në realizimin e kontratës mund të shkaktojë dëme të mëdha në rrjetin e transmetimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, të paktën 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, kerkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në

kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros per tre vitet e fundit financiare te jete ne masen 35,000,000 (tridhjetë e pese milion) Leke, jo me e larte se dyfishi i vleres se parashikuar te kontrates, sipas parashikimeve te nenit 43/2/a te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 7,000,000 (shtate milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më shume se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine, afatin dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:

➤ *ISO 9001: Per menaxhimin e cilesise, qe ka lidhje me objektin e kontrates;*

- *ISO 27001: Per menaxhimin e sigurise se informacionit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*
- *ISO/IEC 20000-1: Për menaxhimin e shërbimeve.*
- *ISO 22301: Për vazhdimësinë e biznesit.*

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

ISO 9001: - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 27001: - Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

ISO/IEC 20000-1: - Ky standard është i nevojshëm për të specifikuar kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit. Ky sistem mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat përmbushin kërkesat e dakorduara dhe japin vlerë për konsumatorët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbime. Ky standard u jep kompanive mundësinë të demonstrojnë aftësitë profesionale të tyre në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

ISO 22301: - Nëpërmjet këtij certifikimi, kompania duhet të demonstrojë aftësinë për të konceptuar dhe hartuar plane të parandalimit dhe rikuperimit, për tu përballur me kërcënime të mundshme dhe për të mundësuar vazhdimësinë shërbimeve të biznesit të OST.

Sa më sipër janë kërkuar certifikata që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standarteve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Kërkesat janë të mjaftueshme për të siguruar ofertues me kapacitete teknike cilësore të certifikuar edhe me certifikata menaxhimi të cilësisë të njohura ndërkombëtarë. Certifikatat e kërkuara për OE janë në

përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Çertifikatat e kërkuara janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike si dhe u arsyetuan të nevojshme për të siguruar ofertues serioze.

AK duhet të marrë çdo masë të nevojshme për parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarisë së saj, ku për shkak të moscertifikimit të duhur të kontraktoreve, AK duhet të pezullojë ose të vonojë punën e saj, duke shkaktuar një dëm të madh në sistemin elektro energjistik shqiptar, ku është edhe veprimtaria e saj kryesore.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për pajisjet dhe platformat (Switche, Cisco, Fortigate, platforme NAC, sistemi NMS, Akses Point, Switche Akses). Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Suporti ose autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e produkteve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë që kërkohen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin teknik si vijon:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL për menaxhimin e shërbimeve TI.*
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, për pajisjet e rrjetit të tipit switch.*
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, për sistemin e menaxhimit të politikave të sigurisë dhe aksesit në rrjet.*
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, për rrjetin wireless.*

- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuara/certifikuara për dhënien e tyre, për pajisjet e sigurisë.

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certificate.

Operatori Ekonomik ofertues mund te disponoje punonjesit e mesiperm ne dy menyra:

- i. Ne stafin e tij dhe per kete duhet te kete listepagesen e fundit e-sig, kontratat e punes dhe certifikimet perkatese.
- ii. Me ane te kontraktimit dhe per kete duhet te kete kontraten noteriale dhe certifikimet paktese.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin si prove paraprake formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter lidhet ngushte me specifikimet teknike për shërbimin e kërkuar, lidhur me menaxhimin në menyre të pavaruar. AK duhet të kete besueshmerine dhe te kerkoje garanci per realizimi me sukses te kontrates objekt prokurimi, duke perfshire kerkesat për nje staf te kualifikuar i cili ti pergjigjet me se miri nevojave te kerkuara ne kete procedure.

Ky kriter mbeshtetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Punonjësi i certifikuar në nivelin profesional për menaxhimin e shërbimeve TI - Ky kriter shërben për të vërtetuar aftësitë profesionale në konfigurimin dhe adaptimin apo rifreskimin e liçensave dhe përditësimeve të fundit nga prodhuesit e paisjeve të rrjetit, si dhe ndryshime në logjikën e rrjetit të komunikimit.

Punonjësi i certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit te tipit switch - Ky certifikim është kriter i rëndësishëm sepse projekti përfshin dhe mirembajtjen e pajisjeve te rrjetit te tipit switch. OE duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme për të operuar dhe suportuar plotësisht pajisjet ne fjale, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse

Punonjësi i certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Sistemin e menaxhimit te politikave te sigurise dhe aksesit ne rrjet - Ky certifikim është kriter i rëndësishëm sepse projekti përfshin mirëmbajtjen e sistemit NAC (Network Access Control) dhe OE duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme për të operuar plotësisht sistemin, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i tij.

Punonjësi i certifikuar nga prodhuesi për rrjetin wireless - Ky certifikim është kriter i rëndësishëm sepse projekti përfshin dhe mirembajtjen e pajisjeve te rrjetit te tipit wireless. OE

duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme për të operuar dhe suportuar plotësisht pajisjet ne fjale, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse.

Punonjësi i certifikuar nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë - Ky çertifikim është kriter i rëndësishëm sepse projekti përfshin dhe mirembajtjen e pajisjeve të sigurisë. OE duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme për të operuar dhe suportuar plotësisht pajisjet ne fjale, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse.

2.3.5 *Ne funksion të plotësimin të Shtojcës 10 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Ates, Amesi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, ates, amesi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe Termat e References, janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, duke përfshirë sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.